

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenin 85, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, si dhe në zbatim të Rregullores për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto, Bordi Ekzekutiv, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, miratoi këtë:

**UDHËZIM METODOLOGJIK**  
**PËR RAPORTIMIN E TREGUESIT TË FINANCIMIT TË**  
**QËNDRUESHËM NETO**

*Data efektive: 1 janar 2023*

*Qëllimi i këtij udhëzimi metodologjik është të përcaktojë metodologjinë e raportimit të treguesit të financimit të qëndrueshëm neto. Ky udhëzim metodologjik është përpiluar në funksion të zbatimit të Rregullores për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto. Ky udhëzim metodologjik zbatohet për bankat e licencuara nga BQK, duke përfshirë degët e bankave të huaja.*

## **PJESA 1**

### **UDHËZIME TË PËRGJITHSHME**

1. Ky dokument përfshinë udhëzimet për raportimin e treguesit të financimit të qëndrueshëm neto (në vijim: treguesi NSFR) dhe përmban informata në lidhje me zërat e financimit të qëndrueshëm të kërkuar dhe atë në dispozicion, për qëllime të raportimit të treguesit NSFR të kërkuar sipas Rregullores për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto (më tutje: Rregullorja për NSFR). Fushat që nuk duhet të plotësohen nga bankat janë të hijezuara me ngjyrë hiri.
2. Bankat duhet të raportojnë formularin në valutën Euro, pavarësisht nga denominimi aktual i aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtëbilancorë. Bankat do të raportojnë ndaras formularin nëse detyrimet agregate në një valutë të ndryshme nga Euro arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithsej detyrimeve të bankës.
3. Në lidhje me kalkulimin e treguesit NSFR, Rregullorja për NSFR i referohet faktorëve të financimit të qëndrueshëm. Fjala “faktor” në kontekst të këtyre udhëzimeve i referohet një numri ndërmjet 0 dhe 1, i cili shumëzuar me shumën jep shumën e peshuar ose vlerën sipas paragrafit 2 të nenit 5 të Rregullores për NSFR.
4. Për të shmangur çdo numërim të dyfishuar, bankat nuk duhet të raportojnë asetet dhe detyrimet që janë të lidhura me kolateralin e dorëzuar apo pranuar si margjinë ndryshuese në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 24 të Rregullores për NSFR dhe margjinës fillestare në pajtueshmëri me nënparagrafin 1.1 të nenit 23 të së njëjtës rregullore.
5. Për qëllime të raportimit, në kolonat e referuara si “Shumë” apo “Shuma” duhet gjithmonë të raportohet vlera kontabël, përveç në rastet e kontratave të derivativëve për të cilat bankat duhet të përdorin vlerën fer të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 6 të Rregullores për NSFR.
6. Për qëllime të raportimit sipas valutës që është subjekt i raportimit të ndarë në lidhje me derivativët, siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 6 të Rregullores për NSFR, bankat duhet të kalkulojnë vlerën fer të secilit set të netimit në valutën e tij të shlyerjes. Për të gjitha setet e netimit që kanë të njëjtën valutë të shlyerjes, duhet të kalkulohet vlera neto në pajtueshmëri me paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 si dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 24 të Rregullores për NSFR, dhe të raportohet në valutën relevante nëse është

subjekt i raportimit të ndarë. Në këtë kontekst, valuta e shlyerjes nënkuptohet si valutë përmes të cilës është dakorduar shlyerja e setit të netimit. Seti i netimit i referohet grupit të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve që rrjedhin nga transaksionet e derivativëve me kundërpalën, pavarësisht nëse ato janë denominuar në një valutë tjetër ndryshe nga valuta e shlyerjes. Në rastin e opsionit të valutave të shumta (ang. multi-currency optionality), banka duhet të vlerësojë valutën në të cilën ka të ngjarë të ndodhë shlyerja dhe duhet të raportojë vetëm në atë valutë të ndarë.

7. Për qëllime të kalkulimit të treguesit NSFR bankat duhet të përdorin formularët e raportimit mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar, mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion dhe mbi Përmbledhjen e NSFR.

## **PJESA 2**

### **FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR (RSF)**

#### **1. Shënime specifike**

1. Bankat duhet të raportojnë në kategoritë e përshtatshme të gjitha asetet ndaj të cilave posedojnë pronësinë e përfituesit edhe nëse ato nuk janë të përfshira në bilancin e tyre të gjendjes. Asetet ndaj të cilave bankat nuk posedojnë/mbajnë pronësinë e përfituesit nuk duhet të raportohen edhe nëse këto asete janë të përfshira në bilancet e tyre të gjendjes.
2. Në pajtueshmëri me nenin 15 të Rregullores për NSFR, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Kapitullin IV të Rregullores për NSFR, shuma e financimit të qëndrueshëm të kërkuar (më tutje: shuma RSF) do të kalkulohet duke shumëzuar vlerën e aseteve dhe zërave jashtëbilancorë me faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar (më tutje: faktorët RSF).
3. Asetet e pranueshme si asete likuide me cilësi të lartë të likuiditetit (ang. HQLA) në pajtueshmëri me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet do të raportohen si të tilla pa marrë parasysh nëse ato plotësojnë kërkesat operationale të përcaktuara në nenin 8 të po të njëjtës rregullore. Këto asete duhet të raportohen në kolonat e përcaktuara pavarësisht nga maturiteti i mbetur i tyre.
4. Asetet dhe zërat jashtëbilancorë që nuk klasifikohen si asete me cilësi të lartë të likuiditetit (ang. non-HQLA) duhet të raportohen sipas maturitetit të mbetur të tyre në pajtueshmëri me nenin 16 të Rregullores për NSFR. Intervalet kohore të shumës, faktorëve standard dhe faktorëve të aplikueshëm janë si në vijim:

- I. Maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit apo pa maturitet të përcaktuar;

## II. Maturitet të mbetur prej 1 viti ose më gjatë.

5. Gjatë kalkulimit të maturitetit të mbetur të aseteve dhe zërave jashtëbilancorë të cilësuar si asete me cilësi jo të lartë të likuiditetit (ang. non-HQLA), bankat duhet të marrin parasysh opsionet duke u bazuar në supozimin që lëshuesi apo kundërpala do të ekzekutojë çdo opsion për të zgjatur maturitetin e asetit. Për opsionet e ekzekutueshme në diskrecion të bankës, banka duhet të merr parasysh faktorët reputacional që mund të që mund të ndikojnë në kufizimin e aftësisë së bankës për të mos ekzekutuar kontratën e opsionit, në veçanti duke konsideruar pritshmëritë e tregjeve dhe klientëve që banka duhet të zgjatë maturitetin e aseteve të caktuara në datën e maturimit të tyre.
6. Për disa zëra, bankat duhet t'i raportojnë asetet sipas gjendjes/statusit të ngarkesës (ang. encumbrance) dhe/apo maturitetin e ngarkesës të atij aseti në pajtueshmëri me paragrafët 4, 5 dhe 6 të nenit 15 të Rregullores për NSFR.
7. Ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 15 të Rregullores për NSFR, në rastet kur banka e ri-përdorë apo ri-vendosë si kolateral një aset që është marrë hua, përfshirë në transaksionet e financuara me letrat me vlerë, dhe që është i llogaritur si aset jashtë-bilancor, transaksioni përmes të cilit ky aset është huazuar duhet të trajtohet si i ngarkuar (ang. encumbered) deri në masën që ky transaksion nuk mund të maturojë pa e kthyer banka asetin e marrë hua.

## 2. Udhëzimet lidhur me kolonat specifike

Kolona	Instruktionet dhe referencat ligjore
0010-0020	<p><b><u>Shuma e aseteve me cilësi jo të lartë të likuiditetit (më tutje: non-HQLA)</u></b></p> <p>Bankat duhet të raportojnë në kolonat 0010-0020 shumën, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Kapitullin IV të Rregullores për NSFR, të aseteve dhe zërave jashtëbilancorë të referuar në Nënkapitullin II të Kapitullit IV të Rregullores për NSFR.</p> <p>Shuma duhet të raportohet në kolonat 0010-0020 në rastet kur zëri përkatës nuk është i pranueshëm si aset likuid në pajtueshmëri me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, pavarësisht nëse ato janë në pajtueshmëri me kërkesat operationale të përcaktuara në nenin 8 të po të njëjtës rregullore.</p>
0030	<p><b><u>Shuma e aseteve me cilësi të lartë të likuiditetit (më tutje: HQLA)</u></b></p> <p>Shiko udhëzimet për kolonat 0010-0020.</p> <p>Bankat duhet të raportojnë shumën në kolonën 0030 kur zërat përkatës janë</p>

	të pranueshëm si asete likuide në pajtim me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, pavarësisht nëse ato janë në pajtueshmëri me kërkesat operacionale të përcaktuara në nenin 8 të po të njëjtës rregullore.
0040-0060	<b><u>Faktorët standard të RSE</u></b> Nënkapitulli II i Kapitullit IV të Rregullores për NSFR. Faktorët standard në kolonat 0040-0060 janë ato të përcaktuara në Kapitullin IV të Rregullores për NSFR që do të përcaktojnë pjesën e shumës së aseteve dhe zërave jashtëbilancorë si shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar. Ato janë dhënë vetëm si informacion dhe nuk duhet të plotësohen nga bankat.
0070-0090	<b><u>Faktorët e aplikueshëm të RSE</u></b> Kapitulli II dhe IV të Rregullores për NSFR. Bankat duhet të raportojnë në kolonat 0070-0090 faktorët e aplikueshëm që do të përdoren sipas Kapitullit IV të Rregullores për NSFR. Faktorët e aplikueshëm mund të rezultojnë në vlerat mesatare të peshuara dhe duhet të raportohen në vlera dhjetore (p.sh. 1.00 për peshën e aplikuar prej 100% apo 0.50 për peshën e aplikuar prej 50%).
0100	<b><u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar:</u></b> Bankat duhet të raportojnë shumën RSF në kolonën 0100 në pajtueshmëri me Kapitullin IV të Rregullores për NSFR. Për kalkulim do të përdoret formula e mëposhtme: $c0100 = \text{SUM}\{(c0010 * c 0070), (c0020 * c 0080), (c0030 * c 0090)$

### 3. Udhëzimet lidhur me rreshtat specifik

Rreshti	Udhëzimet dhe referencat ligjore
1	<b><u>1 FINANCIM I LOËNDRUESHËM I KËRKUAR</u></b> Kapitulli IV i Rregullores për NSFR. Bankat do të raportojnë këtu zërat që janë subjekt i financimit të qëndrueshëm të kërkuar në pajtueshmëri me Kapitullin IV të Rregullores për NSFR.

2	<p><b><u>1.1 RSF nga asetet e Bankave Qendrore</u></b></p> <p>Nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të nenit 17 të Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu asetet e Bankave Qendrore.</p> <p>Shënim: faktori i zvogëluar mund të aplikohet në pajtueshmëri me paragrafin 7 të nenit 15 të Rregullores për NSFR.</p>
3	<p><b><u>1.1.1 paraja e gatshme, rezervat dhe ekspozimet HOLA ndaj bankave qendrore</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë këtu paratë e gatshme dhe rezervat e mbajtura në Bankat Qendrore, përfshirë tepricën e rezervës. Bankat gjithashtu do të raportojnë këtu çdo ekspozim tjetër ndaj bankave qendrore që konsiderohet si aset likuid në pajtueshmëri me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, pavarësisht nëse ato i plotësojnë kërkesat operationale sipas nenin 8 të po të njëjtës rregullore.</p> <p>Rezervat minimale që nuk konsiderohen si asete likuide sipas Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet do të raportohen në kolonën relevante të aseteve me cilësi jo të lartë të likuiditetit (non-HQLA).</p>
4	<p><b><u>1.1.2 ekspozimet tjera non-HOLA ndaj bankave qendrore</u></b></p> <p>Bankat këtu do të raportojnë çdo kërkesë ndaj bankave qendrore të tjerat nga ato të raportuara në pikën 1.1.1 më lartë.</p>
5	<p><b><u>1.2 RSF nga asetet likuide</u></b></p> <p>Nenet 16 deri 20 dhe Neni 22 të Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu asetet likuide në pajtueshmëri me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, pavarësisht nëse ato i plotësojnë kërkesat operationale sipas nenin 8 të po të njëjtës rregullore.</p>
6	<p><b><u>1.2.1 asetet e nivelit 1 për të cilat aplikohet faktori zvogëluar prej 0%</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë këtu asetet që janë të pranueshme si asete likuide të Niveli 1 në pajtueshmëri me nenin 10 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p>
7	<p><b><u>1.2.1.1 të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 6 muaj</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.2.1 që korrespondon me asetet që janë të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 6 muaj.</p>

8	<p><b><u>1.2.1.2 të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej së paku 6 muaj por më pak se 1 vit</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.2.1 që korrespondon me asetet që janë të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej së paku 6 muaj por më pak se 1 vit.</p>
9	<p><b><u>1.2.1.3 të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.2.1 që korrespondon me asetet që janë të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë.</p>
10	<p><b><u>1.2.2 asetet e niveli 2A për të cilat aplikohet faktori zvogëluar prej 15%</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë këtu asetet që janë të pranueshme si asete të Niveli 2A në pajtueshmëri me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p>
11	<p><b><u>1.2.2.1 të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 6 muaj</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.2.2 që korrespondon me asetet që janë të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 6 muaj.</p>
12	<p><b><u>1.2.2.2 të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej së paku 6 muaj por më pak se 1 vit</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.2.2 që korrespondon me asetet që janë të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej së paku 6 muaj por më pak se 1 vit.</p>
13	<p><b><u>1.2.2.3 të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.2.2 që korrespondon me asetet që janë të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë.</p>
14	<p><b><u>1.2.3 asetet e niveli 2B për të cilat aplikohet faktori zvogëluar prej 50%.</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë këtu asetet që janë të pranueshme si asete të Niveli 2B për të cilat aplikohet faktori zvogëluar prej 50% në pajtueshmëri me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p>
15	<p><b><u>1.2.3.1 të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 1 vjet</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.2.3 që korrespondon me asetet që janë të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 1 vjet.</p>

16	<p><b><u>1.2.3.2 të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.2.3 që korrespondon me asetet që janë të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë.</p>
17	<p><b><u>1.3 RSF nga letrat me vlerë të tjera nga asetet likuide</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2 i nenit 21, nënparagrafi 1.4 i nenit 23 dhe nënparagrafi 1.2 i nenit 24 të Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu letrat me vlerë që nuk janë të klasifikuara si të dështuara dhe që nuk konsiderohen si asete likuide sipas Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, pavarësisht nëse ato i plotësojnë kërkesat operacionale të po të njëjtës rregullore.</p>
18	<p><b><u>1.3.1 të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 1 vjet</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.3 që korrespondon me asetet që janë të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 1 vjet.</p>
19	<p><b><u>1.3.2 të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.3 që korrespondon me asetet që janë të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë.</p>
20	<p><b><u>1.4 RSF nga kreditë</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë këtu shumat për tu marrë nga kreditë që nuk klasifikohen si të dështuara.</p> <p>Ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të Rregullores për NSFR, për kreditë amortizuese me maturitetin e mbetur kontraktual prej 1 viti apo më shumë, pjesët që maturojnë në më pak se 6 muaj dhe midis 6 muaj dhe më pak se 1 vit do të trajtohen sikurse maturiteti i tyre i mbetur të jetë prej më pak se 6 muaj dhe midis 6 muaj dhe më pak se 1 vit respektivisht.</p>
21	<p><b><u>1.4.1 kreditë ndaj klientëve jofinanciarë</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në 1.4 që korrespondon me kreditë ndaj klientëve jofinanciarë.</p>
22	<p><b><u>1.4.1.1 të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 1 vjet</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.1 i nenit 21 dhe nënparagrafi 1.2 i nenit 23 të Rregullores për NSFR</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.4.1 që korrespondon me asetet që janë të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 1 vjet.</p>



23	<p><b><u>1.4.1.2 të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2 i nenit 24 i Rregullores për NSFR</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.4.1 që korrespondon me asetet që janë të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë.</p>
24	<p><b><u>1.4.2 kreditë ndaj klientëve financiarë</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në 1.4 që korrespondon me kreditë ndaj klientëve financiarë.</p>
25	<p><b><u>1.4.2.1 të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 1 vjet</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.1 i nenit 21 dhe nënparagrafi 1.2 i nenit 24 të Rregullores për NSFR.</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.4.2 që korrespondon me asetet që janë të lira apo të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej më pak se 1 vjet.</p>
26	<p><b><u>1.4.2.2 të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2 i nenit 24 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.4.2 që korrespondon me asetet që janë të ngarkuara për maturitetin e mbetur prej 1 viti apo më gjatë.</p>
27	<p><b><u>1.4.3 produktet e financimit tregtar në bilancin e gjendjes</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2 i nenit 21 dhe nënparagrafi 1.3 i nenit 23 të Rregullores për NSFR</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.4 që rrjedh nga produktet e financimit tregtar të regjistruara në bilancin e gjendjes.</p>
28	<p><b><u>1.5 RSF nga derivativet</u></b></p> <p>Neni 6, paragrafi 2 i nenit 18, nënparagrafi 1.1 i nenit 23 dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 24 të Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar që rrjedh nga derivativët.</p>
29	<p><b><u>1.5.1 financimi i qëndrueshëm i kërkuar për detyrimet derivative</u></b></p> <p>Paragrafi 2 i nenit 18 i Rregullores për NSFR</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.5, që është vlera absolute fer e seteve të netimit me vlerën fer negative të kalkuluar në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 18 të Rregullores për NSFR.</p>

30	<p><b><u>1.5.2 asetet derivative - NSFR</u></b></p> <p>Neni 6 dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 24 të Rregulloren për NSFR.</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.5, që është diferenca pozitive në mes të seteve të netimit e kalkuluar sipas paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 24 të Rregullores për NSFR.</p>
31	<p><b><u>1.5.3 margjina fillestare e postuar</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.1 i nenit 23 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.5 që korrespondon me margjinën fillestare për kontratat derivative.</p>
32	<p><b><u>1.6 RSF nga asetet tjera</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë këtu çdo aset që nuk është përfshirë në pikat 1.1 deri 1.5 më lartë.</p>
33	<p><b><u>1.7 RSF nga zërat jashtëbilancorë</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë këtu shumën e zërave jashtëbilancorë që nuk janë përfshirë në pikat 1.1 deri 1.5 më lartë e që janë subjekt i kërkesave për financim të qëndrueshëm të kërkuar.</p>
34	<p><b><u>1.7.1 lehtësirat e zotuar</u></b></p> <p>Paragrafi 1 i nenit 18 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.7, që është lehtësirë e zotuar në pajtueshmëri me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p>
35	<p><b><u>1.7.2 zërat jashtëbilancorë të financimit tregtar</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.1 i nenit 19 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Shuma e raportuar në 1.7, që është produkt i lidhur me zërat jashtëbilancorë të financimit tregtar të referuar në Aneksin I të Rregullores për NSFR.</p>
36	<p><b><u>1.7.3 zërat jashtëbilancorë jo-performues</u></b></p> <p>Shuma e raportuar në pikën 1.7 që korrespondon me ekspozimet jo-performuese.</p>
37	<p><b><u>1.7.4 ekspozimet jashtëbilancore të tjera të përcaktuara nga BOK-ja</u></b></p> <p>Paragrafi 11 i nenit 15 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Shuma e raportuar në 1.7 lidhur me ekspozimet jo-performuese për të cilat BQK ka përcaktuar faktorët RSF në pajtueshmëri me paragrafin 11 të nenit 15 të Rregullores për NSFR.</p>

**PJESA 3**  
**FINANCIMI I QËNDRUESHËM NË DISPOZICION**

**1. Shënime specifike**

1. Të gjithë detyrimet dhe kapitali duhet të raportohen të shpërndara sipas maturitetit kontraktual të tyre në pajtueshmëri me Nenin 9 të Rregullores për NSFR. Intervallet kohore të shumës, faktorëve standard të financimit të qëndrueshëm në dispozicion (më tutje ASF) dhe faktorëve e aplikueshëm të ASF janë si në vijim:
  - I. Maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit apo pa maturitet të përcaktuar;
  - II. Maturitet të mbetur prej 1 viti ose më gjatë.
2. Të gjitha detyrimet me maturitet të mbetur prej një viti apo më gjatë do të jenë subjekt i faktorit ASF prej 100% në pajtueshmëri me Nenin 14 të Rregullores për NSFR, përveç nëse përcaktohet ndryshe në nenet 10-13 të së njëjtës rregullore.
3. Të gjitha depozitat në të parë do të raportohen në intervalin që i referohet detyrimeve me maturitet të mbetur prej më pak se një viti.
4. Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 9 të Rregullores për NSFR, bankat do të marrin parasysh kontratat ekzistuese të opsioneve për të përcaktuar maturitetin e mbetur të një detyrimi apo kapitali të bankës. Bankat gjithashtu duhet të marrin parasysh supozimet se kundërpala do të riblejë opsionet në blerje në datën më të hershme të mundshme. Për kontratat e opsioneve të ekzekutueshme në diskrecion të bankës, banka duhet të merr parasysh faktorët reputacional që mund të ndikojnë në kufizimin e aftësisë së bankës për të mos ekzekutuar kontratën e opsionit, në veçanti pritjet e tregut që bankat duhet t'i riblejnjë disa detyrime para maturitetit të tyre.
5. Për më tepër, siç është përcaktuar në nenin 14 të Rregullores për NSFR, zërat e kapitalit shtesë të klasës së parë, zërat e kapitalit të klasës së dytë si dhe çdo instrument tjetër të kapitalit me kontratat që përfshijnë opsione eksplicite apo të përfshira (ang. embedded) që, nëse ekzekutohen (edhe nëse ato ende nuk janë të ekzekutuara në datën referuese të raportimit), do të zvogëlojnë maturitetin efektiv të mbetur në datën referuese të raportimit në më pak se 1 vit, nuk duhet të trajtohen me faktorin ASF prej 100%.
6. Në pajtim me paragrafin 3 të nenit 9 të Rregullores për NSFR, bankat do të trajtojnë depozitat me kohë të përcaktuar të njoftimit sipas kësaj kohe të përcaktuar të njoftimit dhe duhet t'i trajtojnë depozitat me afat në pajtueshmëri me maturitetin e tyre të mbetur. Duke e përjashtuar paragrafin 3 të kësaj pjese të dokumentit, më konkretisht pjesa për financimin e qëndrueshëm në dispozicion, bankat nuk duhet të marrin parasysh mundësinë e tërheqjes së hershme atëherë kur depozituesi duhet të paguaj një ndëshkim material për shkak të tërheqjeve të hershme të cilat ndodhin brenda periudhës 1 vjeçare, për të përcaktuar maturitetin e mbetur të depozitave me afat.

## 2. Udhëzimet lidhur me kolonat specifike

Kolona	Udhëzimet dhe referencat ligjore
0010-0020	<p><b><u>Shuma</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë në kolonat 0010-0020 shumën e detyrimeve dhe kapitalit të shpërndarë në intervalet e dhura të maturitetit të mbetur.</p>
0030-0040	<p><b><u>Faktorët standard të ASF</u></b></p> <p>Nënkapitulli II i Kapitullit III të Rregullores për NSFR</p> <p>Faktorët standard në kolonat 0030-0040 janë ato të përcaktuara në Kapitullin III të Rregullores për NSFR të cilët përcaktojnë pjesën e shumës të detyrimeve dhe kapitalit si financim i qëndrueshëm në dispozicion. Këta faktorë janë dhënë vetëm si informacion dhe nuk duhet të plotësohen nga bankat.</p>
0050-0060	<p><b><u>Faktorët e aplikueshëm të ASF</u></b></p> <p>Kapitulli II dhe III të Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat do të raportojnë në kolonat 0050-0060 faktorët e aplikueshëm të ASF sipas Kapitullit III të Rregullores për NSFR si pesha që kur të shumëzohen me shumën e detyrimeve dhe kapitalit do të përcaktojnë shumën relevante të financimit të qëndrueshëm në dispozicion. Faktorët e aplikueshëm duhet të raportohen në vlera dhjetore (p.sh. 1.00 për faktorin e aplikueshëm prej 100% apo 0.50 për faktorin e aplikueshëm prej 50%).</p>
0070	<p><b><u>Financimi i qëndrueshëm në dispozicion</u></b></p> <p>Bankat do të raportojnë në kolonën 0070 vlerën e financimit të qëndrueshëm në dispozicion në pajtueshmëri me përkufizimin e përcaktuar në Nenin 8 të Rregullores për NSFR.</p> <p>Kjo kalkulohet përmes formulës në vijim:  <math>c0070 = \text{SUM}\{(c0010 * c 0050), (c0020 * c 0060)</math></p>

### 3. Udhëzimet lidhur me rreshtat specifik

Rreshti	Udhëzimet dhe referencat ligjore
1	<p><b><u>2. FINANCIMI I QËNDRUESHËM NË DISPOZICION</u></b></p> <p>Kapitulli III i Rregullores për NSFR.</p>
2	<p><b><u>2.1 ASF nga zërat dhe instrumentet e kapitalit</u></b></p> <p><b><u>Kapitali bazë i klasës së parë</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.1 i nenit 14 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Zërat e kapitalit bazë të klasës të parë të bankës para aplikimit të përshtatjeve rregullative të përcaktuara në Nenet 20, 21 dhe Nenet 30 deri 36 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe paragrafit 6 të nenit 47 të Ligjit për Bankat.</p> <p><b><u>Kapitali shtesë i klasës së parë</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2 i nenit 14 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Zërat e kapitalit shtesë të klasës së parë të bankës para aplikimit të përshtatjeve rregullative të përcaktuara në Nenet 20, 21 dhe Nenet 30 deri 36 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe paragrafit 6 të nenit 47 të Ligjit për Bankat.</p> <p><b><u>Kapitali i klasës së dytë</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.3 i nenit 14 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Zërat e kapitalit të klasës së dytë të bankës para aplikimit të përshtatjeve rregullative të përcaktuara në Nenet 20, 21 dhe Nenet 30 deri 36 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe paragrafit 6 të nenit 47 të Ligjit për Bankat.</p> <p><b><u>Instrumentet tjera të kapitalit</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.4 i nenit 14 dhe nënparagrafi 3.3 i nenit 10 të Rregullores për NSFR.</p> <p>Instrumentet tjera të kapitalit që nuk përmenden në asnjërën nga kategoritë e lartpërmendura.</p>

3	<p><b><u>2.2 ASF nga depozitat me pakicë</u></b></p> <p>Paragrafi 2 i nenit 8 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu obligacionet dhe letrat tjera me vlerë të borxhit të emetuara, të shitura ekskluzivisht në tregun me pakicë (ang. retail market), dhe të cilat mbahen në llogari me pakicë (ang. retail account). Këto duhet të raportohen edhe në kategoritë korresponduese të depozitave me pakicë (ang. retail deposits) si depozitat stabile me pakicë (ang. stable retail deposits) apo depozitat tjera me pakicë (ang. other retail deposits) në ID 2.2.1 dhe ID 2.2.2 të formularit raportues.</p> <p>Paragrafi 3 i nenit 9 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu depozitat me pakicë të cilat afatin e maturimit e kanë më shumë së 1 vit por mund të tërhiqen para maturimit të tyre me pagimin e një gjobe e cila është vlerësuar si materiale dhe duhet t'i vendosin në kategoritë korresponduese të depozitave me pakicë si “depozitat stabile me pakicë” apo “ depozita tjera me pakicë” në ID 2.2.1 dhe ID 2.2.2 të formularit raportues.</p> <p>Kjo pikë përfshinë detyrimet e siguruar dhe të pasiguruar (pa garantuar).</p>
4	<p><b><u>2.2.1 Depozitat stabile me pakicë</u></b></p> <p>Neni 13 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat këtu do të raportojnë pjesën e depozitave me pakicë të mbuluara nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës ose një skemë ekuivalente e garantimit të depozitave nga shteti i huaj dhe ose është pjesë e një marrëdhënieje të krijuar më parë me bankën, që e bën pothuajse të pamundur tërheqjen e depozitës ose mbahet në formën e një llogarie të transaksioneve (llogari rrjedhëse) në pajtueshmëri me paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 19 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet respektivisht dhe atëherë kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• këto depozita nuk i plotësojnë kriteret për normën më të lartë të rrjedhës dalëse në pajtim me paragrafët 2,3,4 apo 8 të nenit 20 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet në të cilin rast këto duhet të raportohet si “depozitat tjera me pakicë”; apo</li> <li>• këto depozita nuk janë marrë në shtetet e huaja ku aplikohet norma më e lartë e rrjedhës dalëse sipas paragrafit 8 të nenit 20 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, në të cilin rast do të raportohen si “ depozitat tjera me pakicë”.</li> </ul>
5	<p><b><u>2.2.2 Depozitat tjera me pakicë</u></b></p> <p>Neni 12 i Rregullorës për NSFR.</p> <p>Bankat këtu do të raportojnë shumën e depozitave tjera me pakicë nga ato të vendosura si depozitat stabile me pakicë në ID 2.2.1 të formës raportuese.</p>

6	<p><b><u>2.3 ASF nga klientët jo-financiar “jo me pakicë” (ang. wholesale) përveç Bankave Qendrore</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2 i nenit 11 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Detyrimet ndaj klientëve jo-financiar jo me pakicë (përveç Bankave Qendrore)</p> <p><b><u>Detyrimet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës apo Qeverisë Qendrore të shtetit të huaj;</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2.1 i nenit 11 i Rregullores për NSFR.</p> <p><b><u>Detyrimet ndaj Qeverive regjionale apo autoriteteve lokale të një shteti te huaj</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2.2 i nenit 11 i Rregullores për NSFR.</p> <p><b><u>Detyrimet ndaj entiteteve të sektorit publik të Qeverisë së Kosovës apo të një shteti të huaj</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2.3 i nenit 11 i Rregullores për NSFR.</p> <p><b><u>Detyrimet ndaj Bankave Shumëpalëshe të Zhvillimit dhe Organizatave Ndërkombëtare</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2.4 i nenit 11 i Rregullores për NSFR.</p> <p><b><u>Detyrimet ndaj korporatave jo-financiare</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2.5 i nenit 11 i Rregullores për NSFR.</p> <p><b><u>Detyrimet ndaj unioneve kreditor, kompanive të investimeve private dhe klientëve që janë brokerë të depozitave</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.2.6 i nenit 11 i Rregullores për NSFR.</p>
7	<p><b><u>2.4 ASF nga depozitat operacionale</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.1 i nenit 11 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Depozitat e pranuar për sigurimin e shërbimeve operacionale që plotësojnë kriteret për depozita operacionale të përcaktuara në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p>
8	<p><b><u>2.5 ASF nga klientët financiarë dhe Bankat Qendrore</u></b></p> <p>Nënparagrafi 3.2 i nenit 10 dhe nënparagrafi 1.5 i nenit 14 i Rregullores për NSFR.</p>

	<p><b><u>Detyrimet e marra nga BQK</u></b></p> <p>Nënparagrafi 3.2, pika 3.2.1 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Detyrimet e marra nga BQK, pavarësisht nëse këto janë transaksione të financuara me letra me vlerë.</p> <p><b><u>Detyrimet e marra nga Banka Qendrore Europiane (ECB) apo bankë qendrore e një shteti të huaj</u></b></p> <p>Nënparagrafi 3.2, pika 3.2.2 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Detyrimet e marra nga ECB apo banka qendrore të një shteti të huaj, pavarësisht nëse këto janë transaksione të financuara me letra me vlerë</p> <p><b><u>Detyrimet e marra nga klientët financiarë</u></b></p> <p>Nënparagrafi 3.2, pika 3.2.3 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Detyrimet e marra nga klientët financiarë pavarësisht nëse këto janë transaksione të financuara me letra me vlerë.</p> <p><b><u>Detyrimet ndaj klientëve financiarë dhe Bankave Qendrore me maturitet të mbetur prej 1 viti apo më gjatë</u></b></p> <p>Nënparagrafi 1.5 i nenit 14 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Detyrimet e marra nga klientët financiarë dhe bankat qendrore me maturitet të mbetur prej 1 viti apo më gjatë.</p>
9	<p><b><u>2.6 ASF nga detyrimet atëherë kur kundërpala nuk mund të përcaktohet</u></b></p> <p>Nënparagrafi 3.3 i nenit 10 dhe nënparagrafi 1.5 i nenit 14 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu detyrimet ndaj kundërpalëve që nuk mund të përcaktohen, përfshirë letrat me vlerë të lëshuara për të cilat mbajtësi nuk mund të identifikohet.</p>
10	<p><b><u>2.7 ASF nga detyrimet tjera</u></b></p> <p><b><u>Të pagueshmet sipas datës së tregtimit</u></b></p> <p>Nënparagrafi 3.1 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.</p> <p>Të pagueshmet sipas datës së tregtimit që rrjedhin nga blerjet e instrumenteve financiare, valutave të huaja dhe mallrave (ang.</p>



commodities), që pritet të shlyhen brenda ciklit standard të shlyerjes apo periudhës që është normale për këmbimin përkatës apo llojit të transaksionit, ose që kanë dështuar të shlyhen por pritet të shlyhen.

### **Detyrimet tatimore të shtyra**

Nënparagrafi 1.1 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.

Bankat do të raportojnë këtu detyrimet tatimore të shtyra, të cilat duhet të trajtohen sipas datës më të afërt në të cilën detyrime të tilla mund të realizohen si maturitet i mbetur.

### **Interesi pakicë**

Nënparagrafi 1.2 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.

Bankat do të raportojnë këtu interesin pakicë dhe do të konsiderojnë afatin e instrumentit si maturitet i mbetur.

### **Detyrimet tjera pa maturitet të përcaktuar**

Paragrafi 1 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.

Bankat do të raportojnë këtu detyrimet tjera që nuk kanë maturitet të përcaktuar, përfshirë pozicionet e shkurta dhe pozicionet me maturitet të hapur, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Rregulloren për NSFR.

### **Detyrimet e derivativëve neto**

Paragrafi 4 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.

Diferenca negative në mes të seteve të netimit e kalkuluar në pajtueshmëri me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 10 të Rregullores për NSFR. Të gjitha detyrimet derivative duhet të raportohen si të jenë me maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.

### **Detyrimet tjera**

Nënparagrafi 3.3 i nenit 10 i Rregullores për NSFR.

Çdo detyrim tjetër që nuk është përcaktuar në nenet 10-14 të Rregullores për NSFR.

Të gjithë zërat e kapitalit do të raportohen në pikën 2.1 pavarësisht maturitetit të mbetur të tyre.

**PJESA 4**  
**PËRMBLEDHJE NSFR**

**1. Shënime specifike**

1. Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë udhëzime për bankat për plotësimin e formave të raportimit për treguesin NSFR përmes formularëve mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar dhe mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion.
2. Në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 të Rregullores për NSFR, kërkesa për financim të qëndrueshëm neto do të jetë e barabartë me raportin në mes të shumës së financimit të qëndrueshëm në dispozicion të përcaktuar në Kapitullin III dhe shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar të bankës të përcaktuar në Kapitullin IV të Rregullores për NSFR, të shprehur në përqindje (%). Rregullat për kalkulimin e këtij treguesi janë përcaktuar në Kapitullin II të po të njëjtës rregullore.
3. Zërat në rreshtat 1 deri 16 do të jenë të njëjtë me ato ekuivalente të raportuara në formularët mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar dhe mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion .

**2. Udhëzimet lidhur me kolonat specifike**

Kolona	Udhëzimet dhe referencat ligjore
0010	<b><u>Shuma</u></b> Bankat do të raportojnë në kolonën 0010 shumën e asetëve, zërave jashtëbilancorë, detyrimeve dhe kapitalit të shpërndara sipas shumës së intervaleve të aplikueshme sipas maturitetit të mbetur dhe kualitetit të likuiditetit. Shumat e raportuara do të jenë ato para aplikimit të faktorëve relevant të ASF dhe RSF.
0020	<b><u>Shuma e financimit të qëndrueshëm të kërkuar</u></b> Bankat do të raportojnë në kolonën 0020 shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar në pajtim me Kapitullin IV të Rregullores për NSFR.
0030	<b><u>Shuma e financimit të qëndrueshëm në dispozicion</u></b> Bankat do të raportojnë në kolonën 0030 shumën e financimit të qëndrueshëm në dispozicion në pajtim me Kapitullin III të Rregullores për NSFR.
0040	<b><u>Treguesi</u></b> Bankat do të raportojnë në kolonën 0040 treguesin NSFR në pajtueshmëri

me paragrafin 1 të nenit 4 të Rregulloren për NSFR.

### 3. Udhëzimet lidhur me rreshtat specifik

Rreshti	Udhëzimet dhe referencat ligjore
1	<b><u>1. FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR</u></b> ID 1 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar.
2	<b><u>1.1 RSF nga asetet e bankave qendrore</u></b> ID 1.1 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar.
3	<b><u>1.2 RSF nga asetet likuide</u></b> ID 1.2 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar.
4	<b><u>1.3 RSF nga letrat me vlerë të tjera nga asetet likuide</u></b> ID 1.3 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar.
5	<b><u>1.4 RSF nga kreditë</u></b> ID 1.4 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar.
6	<b><u>1.5 RSF nga derivativët</u></b> ID 1.5 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar.
7	<b><u>1.6 RSF nga asetet tjera</u></b> ID 1.6 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar.
8	<b><u>1.7 RSF nga zërat jashtë bilancorë</u></b> ID 1.7 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar.
9	<b><u>2. FINANCIMI I QËNDRUESHËN NË DISPOZICION</u></b> ID 2 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion.
10	<b><u>2.1 ASF nga zërat dhe instrumentet e kapitalit</u></b> ID 2.1 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm në

	Dispozicion.
11	<p><b><u>2.2 ASF deponizat me pakicë</u></b></p> <p>ID 2.2 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion.</p>
12	<p><b><u>2.3 ASF nga klientët tjerë jo-financiarë (përveç bankave qendrore)</u></b></p> <p>ID 2.3 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion.</p>
13	<p><b><u>2.4 ASF nga deponizat operacionale</u></b></p> <p>ID 2.4 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion.</p>
14	<p><b><u>2.5 ASF nga klientët financiarë dhe bankat qendrore</u></b></p> <p>ID 2.5 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion.</p>
15	<p><b><u>2.6 ASF nga detyrimet për të cilat kundërpala nuk mund të përcaktohet</u></b></p> <p>ID 2.6 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion.</p>
16	<p><b><u>2.7 ASF nga detyrimet tjera</u></b></p> <p>ID 2.7 i formularit raportues mbi Financimin e Qëndrueshëm në Dispozicion.</p>
17	<p><b><u>3. NSFR</u></b></p> <p>NSFR i kalkuluar në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 të Rregullores për NSFR.</p>

**PJESA 5**  
**SHTOJCAT**

Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi metodologjik janë formularët në formë elektronike të cilat do të vendosen në sistemin e raportimit.

**PJESA 6**  
**HYRJA NË FUQI**

Ky udhëzim hyn në fuqi më datën e hyrjes në fuqi të Rregullores për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto.

  
Fehmi Mehmeti  
Kryesues i Bordit Ekzekutiv